



TË DHËNAT PËR ASETIN
Shitja e Aseteve Përmes Likuidimit Nr.69
Njësia e Vendosur në Tender Nr.11
Tokë Komerciale-Strellci Epërm

Emri i NSh.-së	KB "Deçani", Deçan (" Ndërmarrja ") Fi.69/82
Lloji i shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	Më 30.10.2024 nga ora 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
Regjistrimi i Ofertuesit	Nuk ka parakualifikim
Depozita e Ofertës	5,000 Euro
Vendndodhja e Aseteve	Zona Kadastrale Strellci Epërm, komuna Deçan, Rajoni Pejë. Shikoni këtë pronë në Google Maps <i>Të dhënat e hartës ©2024 Google</i> Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	Kjo shitje përfshinë tokën komerciale e regjistruar në certifikatën e pronësisë, parcela kadastrale me nr të njësisë P-70511022-01671-0 me sipërfaqe 1525m ² me kulturë Livadh i klasës 4/Tokë ndërtimore/Oborr 1/1 në vendin e quajtur "Strellci Epërm", Z. K. Strellci Epërm, komuna Deçan, Rajoni Pejë. Në anën veriore të parcelës kadastrale 1671-0 ekziston rrugë fushore.
Ndërtesat dhe tokat	Nuk ka.
Shfrytëzuesit	Parcela është e rrethuar me tel dhe ka disa shtylla betoni. Është ngritur padi dhe kallëzim penal për këtë.
Asetet tjera	Nuk ka.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot
Ose informata të tjera
Për asetet në shitje



Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.



Raporti i vizitës në terren



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORTI NGA VIZITA NË TERREN KB DEÇANI-Parcela kadastrale 1671-0 Z.K Strelci i Epërm

Me datë 02.07.2024 zyrtarët e AKP ZR Pejë prezent në terren ishlim unë Blerita Jashari Kastrati Zyrtare kadastrale dhe Elbarim Rexhepi Zyrtar i operacioneve për administrim të aseteve për identifikimin e tokës e cila sipas certifikatës së pronës evidentohet në pronësi të "P.SH KOPERATIVA BUJQËSORE-DEÇAN ORGANIZATA THEMELORE KOPERATIVISTE" Z.K Strelci i Epërm, Komuna Deçan.

Toka është e regjistruar në certifikatën e pronësisë, parcela kadastrale me nr të njësisë P-70511022-01671-0 me sipërfaqe 1525m² me kulturë Livadh i klasës 4/Tokë ndërtimore/Oborr 1/1 në vendin e quajtur "Strelci i Epërm".



Fig.1 Ortofoto, parcela kadastrale 1671-0 ZK Strelci i Epërm

Nga vizita në terren konstatuam këtë gjendje:

- Parcela kadastrale me nr të njësisë 1671-0 shtrihet në juglindje të zonës kadastrale Strelci i Epërm.
- Gjendja faktike e tokës në terren përputhet me gjendjen kadastrale juridike.
- Në anën veriore të parcelës kadastrale 1671-0 ekziston rrugë fushore.
- Në anën perëndimore të parcelës ekziston një objekt i përkohshëm me sipërfaqe të përafërt prej 7m².
- Është e rrethuar me tel.
- Ka qasje në rrugë magjistrale Deçan Pejë, Deçan Gjakovë.



Fig. 2 Fotografitë e mëposhtme paraqesin gjendjen faktike në terren:



Zyrtare Kadastrale Rajonale:
Blerta Jashari Kastrati

Blerta Jashari Kastrati

Zyrtar i operacioneve për administrim të aseteve:

Elbarim Rexhepi

Elbarim Rexhepi

Faqe 2 / 2

Informatat

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090,2059
Fax: +383 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Dritan Hoxha, nr.55
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës